

NDIKIMI I KRYENGRITJEVE KUNDËR OSMANE GJATË VITEVE 1830-  
1850 NË EMANCIPIMIN E GJITHËMBARSHËM KOMBËTAR TË  
SHQIPTARËVE

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA:

VISAR RUDARI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

*PRISHTINË, 2021*

# NDIKIMI I KRYENGRITJEVE KUNDËR OSMANE GJATË VITEVE 1830-1850 NË EMANCIPIMIN E GJITHËMBARSHËM KOMBËTAR TË SHQIPTARËVE

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti

Kandidati: Visar Rudari

Tema të cilën e kemi elbaroruar në këtë punim përfshin periudhën prej viteve 1830 - 1850 të Perandorisë Osmane, periudhë kjo e cila vuri themelet e krijimit dhe emancipimit të gjithëmbarshtëm të shqiptarëve. Kjo periudhë është mjaft të rëndësishme për historinë shqiptare, në këtë periudhë u hodhën bazat e çdo gjëje që i karakterizon shqiptaret. Në këtë periudhë janë fillimet e tezave dhe ideve mbi prejardhjen e shqiptarëve, pra janë themelet e historiografisë shqiptare. Po ashtu gjatë kësaj periudhe letërsia e arrin një nivel shumë të lart, si dhe kryeveprat kryesore janë të kësaj periudhe. Gjatë kësaj periudhe një element shumë i rëndësishëm ishte kryengritja kundërosmane e cila shprehu edhe idealin e atdhetaëve shqiptarë për krijimin e shtetit të pavarur shqiptar.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të arrij sadopak të ndriçoj rrethanat në të cilat u gjenden shqiptarët në këtë kohë.

Gjithashtu, duhet theksuar se qëllime tjera të këtij punimi janë : ashtu që të diskutohet në lidhje me ndikimin e kryengritjeve kundër osmanëve gjatë viteve 1830 – 1850. Të dihet për këtë periudhë se sa ka ndikuar në emancipimin e gjithëmbarshtëm kombëtarë të shqipëtarëve si dhe rëndësinë e kryengritjeve shqiptare anti-osmane gjatë kësaj periudhe kohore.

Ky punim është e ndarë në gjithsej 3 kapituj, ku në kapitullin e parë do diskutohet rreth gjendjes së shqiptarëve në kuadër të Perandorisë Osmane gjatë viteve të para të shekullit XIX, arsyet e kryengritjeve të viteve 1830 e tutje, ndikimi i tyre si dhe pasojat.

Gjatë kapitullit të dytë do diskutohet rreth kryengritjeve të vitit 40-ta, fillimi i tyre si dhe zhvillimet kryesore. Në kapitullin e tretë do flitet rreth kryengritjeve të viteve 50-ta, me theks të veçantë në kryengritjet e Dervish Carës, pasojat si dhe ndryshimet territoriale, që ndodhën krahas këtyre kryengritjeve. Në fund do ceket përfundimi si dhe literatura e shfrytëzuar për realizimin e këtij punimi.